



## OPINION

### *Lidhur me Publikimin e Listës së Pagave të Nëpunësve Civilë të Komunës së Lypjanit*

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) më datën 01.10.2012, ka pranuar një kërkesë nga Komuna e Lypjanit, në të cilën është kërkuar opinioni i Agjencisë nëse dhënia e kopjeve të listës së pagave të nëpunësve civilë të Komunës së Lypjanit për periudhën dhjetor 2009 – gusht 2012, të kërkuar nga “OJQ Youth Association for Human Rights - YAHR” është në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm: LMDHP).

Duke u bazuar në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta e privatësisë është e drejtë e garantuar, ku në paragrafin 4 të këtij neni parashihet mbrojtja e të dhënave personale që rregullohet me LMDHP. Neni 38 i LMDHP përcakton detyrat e Agjencisë për ofrimin e këshillave për institucionet publike dhe private, dhe në lidhje me kërkesën e bërë nga ana e Komunës së Lypjanit adresuar ASHMDHP-së, jep/lëshon këtë opinion:

***Dhënia e kopjeve të listës së pagave të nëpunësve civilë të administratës së Komunës së Lypjanit, OJQ-së së lartcekur, është në kundërshtim me nenet 2, 3, 5, 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.***

Në bazë të nenit 2 nënparagrafi 1.1. i LMDHP, e dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm.

Në listën e pagave të nëpunësve civilë gjenden informacione si: emri, mbiemri, numri personal, numri i nëpunësit, data e lindjes, paga bruto, paga neto, kontributi pensional, kontributi tatimor, titulli i punës, grada, fondi i orëve, banka, sindikata si dhe përvoja në punë.

Andaj, konstatohet se lista e pagave përmbanë të dhëna personale dhe të dhëna personale të ndjeshme (anëtarësia sindikale) dhe si të tilla duhet të përpunohen sipas LMDHP-së në përputhje me nenin, 2 nënparagrafi 1.2. të LMDHP. Përpunim i të dhënave personale është çdo veprim ose një sërë veprimesh të cilat kryhen me të dhënat personale, në këtë rast zbulimi i të dhënave nga lista e pagave është përpunim i të dhënave personale.

Duke u bazuar në nenin 5, nënparagrafin 1.1. dhe 1.3. të LMDHP-së, të dhënat personale mund të përpunohen nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin e tij/saj dhe nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi.

Sipas nenit 6, nënparagrafit 1.1. dhe 1.2. të LMDHP-së, të dhënat personale të ndjeshme përpunohen në rastet kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, si dhe nëse përpunimi bëhet në pajtim me ligjet përkatëse të cilat po ashtu ofrojnë masa mbrojtëse të përshtatshme për të drejtat e subjektit të të dhënave.

Ligji për Administratën Publike të Kosovës, sipas nenit 32 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, definon strukturën organizative, numrin dhe nivelin e vendeve të punës në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit, ndarjen e punëve në kuadër të strukturës organizative ndërmjet vendeve të punës (duke përfshirë titujt dhe përshkrimet e vendeve të punës, zëvendësimet), kushtet për secilin vend pune, skemën organizative. Në kuptim të kësaj, të gjitha gradat dhe nivelet e punës kanë koeficient përkatës, që janë publikë për opinionin, por jo edhe të dhënat personale të shërbyesve civilë.

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, në nenin 4, paragrafi 1, parashihet se çdo kërkues i dokumentit ka të drejtë në qasje të dokumenteve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj. Neni 12, nënparagrafi 1.6. i këtij ligji përcakton përjashtimin e të drejtës së qasjes në dokumente me qëllim të mbrojtjes së privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat. Nga sa u tha më lart, kopja e listës së pagave, e cila përmbanë të dhëna personale dhe të dhëna personale të ndjeshme, është dokument publik, i cili përjashtohet nga e drejta për qasje.

Ndërkaq, Ligji për Antikorrupsion, sipas nenit 5 për deklarimin e pasurisë, në pragrafët 1-6, rregullon transparencën e deklarimit të pasurisë së luajtshme, të pasurisë së paluajtshme, të të ardhurave vjetore, zotërimit të aksioneve, letrave me vlerë, të

detyrimeve financiare të personave juridikë dhe fizikë të zyrtarëve të lartë publikë dhe familjarëve të tyre.

Të gjitha këto informata me të ardhurat e tyre të kësaj kategorie të të punësuarve, janë të qasshme dhe publike për opinionin në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Agjencia shprehë mendimin se në funksion të transparencës është e mjaftueshme që kërkuarit t'i jepen të dhënat e numrit të punëtorëve, gradat dhe koeficientët e pagave pa emrat e të punësuarve.

Zbulimi i të dhënave personale nga lista e pagave, pa i plotësuar dispozitat e lartcekura, është në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave personale, respektivisht me nenin 3, paragrafin 1 të Ligjit 03/L-172, në të cilin theksohet se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme, pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave, në këtë rast të nëpunësve civilë të Komunës së Lypjanit.